



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË MARTË, 27 QERSHOR 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARJA E KUVENDIT
LINDITA NIKOLLA
(Seanca filloi në orën 13:45)

Rendi i ditës:

1. Fjala e Kryetares së Kuvendit, zonjës Lindita Nikolla.
2. Fjala përshëndetëse e Presidentit të Këshillit Kombëtar të Austrisë, Shkëlqesisë së Tij, zotit Wolfgang Sobotka.

Lindita Nikolla – Mirëdita!
Të nderuar deputetë,
Fillojmë seancën e posaçme.
Sot në Kuvendin e Shqipërisë kemi një mik të nderuar, politikan dhe personalitet të shquar të Austrisë mike, Presidentin e Këshillit Kombëtar, zotin Wolfgang Sobotka.
Presidenti Sobotka do të përshëndesë Kuvendin e Shqipërisë.
Mirëpresim dhe duartrokasim Presidentin e Këshillit Kombëtar të Republikës së Austrisë.
(Duartrokitje në sallë)
Shkëlqesia Juaj, zoti President Sobotka,
Të nderuar shkëlqesi ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik,
Kolege dhe kolegë deputetë,
Zonja e zotërinj,

Kam kënaqësinë t'i uroj mirëseardhjen në Kuvendin e Shqipërisë, Shkëlqesisë së Tij, zotit Wolfgang Sobotka, President i Këshillit Kombëtar të Republikës së Austrisë.

Presidenti Sobotka është ndër partnerët më të ngushtë dhe miqtë më të mirë të Kuvendit të Shqipërisë, një mbështetës e dashamirës i shqiptarëve. Është i vetmi kryeparlamentar që ka ardhur tri herë në Kuvendin e Shqipërisë brenda më pak se pesë vjetëve, çka tregon vullnetin e Këshillit Kombëtar dhe të Austrisë, por edhe vullnetin personal të Presidentit Sobotka për bashkëpunim me Shqipërinë dhe me Kuvendin.

Zoti Sobotka është një politikan i shquar, me një karrierë të spikatur në qeverisje, në veprimtarinë parlamentare dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Zoti Sobotka u zgjodh President i Këshillit Kombëtar të Republikës së Austrisë më 20 dhjetor 2017 dhe u rizgjodh në këtë detyrë të lartë më 23 tetor 2019.

Austria është një vend mik i Shqipërisë dhe bashkëpunimi mes dy vendeve tona vjen duke u zgjeruar. Ne i jemi mirënjohës asaj për mbështetjen e fuqishme të integritit evropian të Shqipërisë; për bashkëpunimin e gjerë dhe intensiv dypalësh në fushat e ekonomisë, mjedisit, kulturës, arsimit, shkencës dhe në mbështetjen e shoqërisë civile; për programet dhe projektet e zhvillimit nëpërmjet Agjencisë Austriake për Zhvillim; për mbështetjen e reformave, posaçërisht reformës në drejtësi dhe luftës kundër korrupsionit; për mbështetjen e bashkëpunimit dhe integritit rajonal të Ballkanit Perëndimor dhe përshpejtimin e rajonit drejt familjes europiane.

Shqipëria dhe Austria janë partnerë të besueshëm në Kombet e Bashkuara, OSBE dhe organizata të tjera ndërkombëtare, si dhe kontribuues për zhvillimin, sigurinë, paqen, stabilitetin në rajon, kontinent e më gjerë.

Mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit Kombëtar të Austrisë po zhvillohet një bashkëpunim i shkëlqyer dhe produktiv. Marrëveshja e Bashkëpunimit mes dy parlamenteve, nënshkruar më 6 mars 2020, i ka intensifikuar marrëdhëniet tona. Një ndër produktet e këtij bashkëpunimi është ngritja në Kuvend e "Punishtes së demokracisë", me mbështetjen dhe sipas modelit të kësaj qendre në Këshillin Kombëtar të Austrisë. "Punishtja e demokracisë" po kontribuon në edukimin qytetar e demokratik të rinisë. Bashkë me Presidentin

Sobotka vijmë nga një bashkëbisedim mbresëlënës me nxënës të shkollave në mjediset e kësaj qendre të rëndësishme të edukimit në Kuvend, si dhe pas vizitës në kantierin e ndërtimit të "Qendrës së vizitorëve", pranë sallës së seancave. Në këtë bashkëpunim të ngushtë dhe frytdhënës parlamentar, pa dyshim, është edhe kontributi i Presidentit Sobotka, të cilit i shpreh mirënjohjen, si një nga partnerët më të ngushtë dhe miqtë më të mëdhenj të Kuvendit të Shqipërisë.

Zonja dhe zotërinj, ftoj Shkëlqesinë e Tij, zotin Wolfgang Sobotka, Presidenti i Këshillit Kombëtar të Republikës së Austrisë, për të përshëndetur Kuvendin e Shqipërisë.

Zoti President, fjala për ju.

Wolfgang Sobotka – Zonja Kryetare Nikolla,

Të nderuar parlamentarë,

Të nderuara ministre dhe ministra,

Të nderuar vizitorë,

Marrëdhëniet Shqipëri-Austri në nivelin parlamentar janë të gjata dhe të qëndrueshme, dhe karakterizohen nga një stabilitet i vazhdueshëm. Vetëm vitin e kaluar, ne kishim "Grupin e miqësisë" nga parlamenti ynë këtu te ju, të cilët sollën me vete përshtypjet më të mira nga vendi juaj dhe shumë nga ato gjëra do të rrjedhin në përditshmërinë e punës sonë. Jam shumë i nderuar që së shpejti do të kemi edhe "Grupin e miqësisë Shqipëri-Austri" nën kryesinë e zonjës Gjonaj, të cilin do të mund ta përshëndesim së shpejti në Austri. Në fakt, ne kemi shumë grupe parlamentare dhe e kemi përparësi të njohim e të shikojmë se si funksionon parlamenti i një vendi dhe se si në grupime të ndryshme shoqërore, ne kemi bashkëpunime të ndryshme. Kjo është një eksperiencë që e ndajmë me shumë parlamente europiane, edhe më gjerë, por sidomos me Shqipërinë. Kjo na ka çuar edhe në faktin që kemi një program bursash dhe vetëm para një jave pata mundësinë të përshëndesja edhe një kolege nga parlamenti juaj. Në fakt, ajo më foli edhe për eksperiencën e saj dhe më tha se ishte një eksperiencë shumë e vlefshme për të: eksperiencia për të mësuar nga njëri-tjetri, për të shoqëruar njëri-tjetrin është vendimtare për ne. Unë mendoj për procesin tonë në Austri dhe ju e shikoni që jam prej disa vjetësh aktiv në politikë dhe e mbaj mend shumë mirë procesin që kemi kaluar ne për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Ka filluar që

në vitet '70 dhe u konkretizua në vitin 1994, kur ne e votuam në parlament, morëm miratimin e qytetarëve nëse duam të anëtarësohemi ose jo dhe deri sot e kësaj dite, vota ka ngelur e njëjtë. Domethënë, për ne Bashkimi Europian, që nga vitet '70 ka qenë një qëllim, dhe historia jonë nuk ka qenë e thjeshtë pas Luftës së Dytë Botërore. Nëse e keni parasysh, ne kemi qenë një vend i pushtuar nga nazistët, por shumë austriakë nuk kanë qenë vetëm viktimë, por kanë qenë edhe bërës të asaj historie dhe, t'i dilje ballë asaj historie, ka qenë goxha e dhimbshme. Ky proces nuk ka mbaruar ende, sepse duhet të vazhdojmë ta ripërpunojmë këtë proces edhe pas vitit '95. Kjo është një punë që kërkohet edhe nga ne në parlament, që t'i dalim për zot asaj gjëje. Megjithatë, kjo është një nevojë që gjeneron perspektivën për të ardhmen. Prandaj, ne e kemi shumë të qartë që vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të jenë pjesë e Bashkimit Europian.

Në fakt, në vitin 2004 janë anëtarësuar disa vende nga Ballkani në Bashkimin Europian. Ne pamë se menjëherë ato ishin në zemër të saj dhe aty u ndërgjegjësuam për faktin e rolit tonë, se çfarë roli kemi ne në historinë e Europës. Kanë qenë ministra me emër, si Alois Mock, i cili ka kontribuar shumë gjatë në këtë fushë, që në moshë të hershme, i cili na ka dhënë me vete një këshillë shumë të mirë - për ta parë në kuadër më të gjerë dhe për ta bërë këtë gjë me zemër. Duke ndjekur këtë politikë, mendoj se parlamenti austriak dhe personalisht unë e kemi shumë të qartë kontributin tonë. Jam shumë i kënaqur dhe ju falënderoj shumë, zonja Kryetare Nikolla, që jam sot këtu dhe që përuruar zyrtarisht bashkë "Punishten e demokracisë". Ju më thatë se ajo është hapur që në shkurt dhe numëron afro 900 të rinj dhe fëmijë, të cilët njihen me strukturat dhe me proceset e demokracisë dhe me detyrat e parlamentarëve, si është e përditshmja e tyre; çfarë bëjnë ata. Sot, në atë diskutim që patëm me ata fëmijë, ne e pamë se sa të interesuar janë ata. Në fakt, mund të shikoni në Europë dhe në të gjithë botën që demokracia lexon nga angazhimi i qytetarëve, ajo jeton nga ky angazhim, sepse gjëja më e thjeshtë që ata kanë për të bërë, është të shkojnë për të votuar, por është shumë e vështirë për ta mbajtur të lartë nivelin e votuesve, të atyre që marrin pjesë. Për shembull, ne kemi pasur në rang kombëtar 70% pjesëmarrje dhe në rang europian 50% pjesëmarrje në zgjedhje dhe duhet

të bëjmë diçka për këtë. Po çfarë mund të bëjmë për këtë, përveçse t'i bëjmë proceset tona më transparente për qytetarët. Në këtë kuadër, them se edhe "Punishtja e demokracisë" luan një rol shumë të rëndësishëm.

Në fakt, që nga 12 janari i këtij viti kemi krijuar të ashtuquajturin "Parlamenti *on tour*", ku ne dalim e vizitojmë qytete të ndryshme me makinat e parlamentit dhe sqarojmë se cila është puna jonë. Me anë të kësaj, duke shkuar pranë qytetarëve, shikojmë që rritet besueshmëria ndaj nesh. Jua them këtë, sepse gjendja në Europë dhe te ne është e tillë që qytetarët gjithmonë e më tepër po e humbin besimin drejt parlamentit, drejt politikanëve, drejt partive, por nuk po e humbin besimi te demokracia dhe ne këtu duhet të kapemi e të krijojmë një dialog të vazhdueshëm me qytetarët. Kjo është ajo që ne i urojmë vetes për Austrinë, dhe kjo është edhe ajo që u urojmë vendeve të tjera. Prandaj ju falënderoj shumë për krijimin e "Punishtes së demokracisë", e cila do ta tregojë efektivitetin e saj ndër vite dhe rezultatet e saj do t'i shikojmë ndër vite. Sot e pamë disi; pas afërsisht 10 apo 15 vjetësh, ne shohim sa e rëndësishme është ajo dhe sa e rrënjësor është demokracia në Austri. 90% e qytetarëve tanë e shohin demokracinë si formën më të mirë të bërjes së shtetit dhe, sigurisht që, edhe pse ka humbur pak besimi në politikë dhe politikëbërje, besimi në demokraci nuk ka humbur. Këtë besim ne duhet ta rritim edhe për sa u përket medie dhe politikanëve që luftojnë për këtë gjë.

Unë pata kënaqësinë që ta shihja në shumë sfera bashkëpunimin tonë dhe, në fakt, për Austrinë është një angazhim shumë i rëndësishëm anëtarësimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian.

Ju keni bërë një punë të shkëlqyer për sa i përket reformës në drejtësi. Ne kemi këtu një parlamentare, e cila ka qenë aktive në këtë proces, që është kryetarja e "Grupit të miqësisë". Ajo ka qenë pjesë e të gjithë kësaj, dhe ju e dini që secili duhet të bëhet pjesë e gjithëpërfshirjes për t'u futur në rrugën e duhur, që është rruga që të çon drejt Bashkimit Europian. Unë ju garantoj që Austria jo vetëm që do të kapet fort pas kësaj rruge, por sigurisht që do të mundohet ta përshpejtojë këtë gjë.

Para një jave në forumin e Vahaut, ministri i Jashtëm Schallenberg i dha zë një iniciative që quhet "*Friends of the Western Balkans*", i cili

mori miratimin e disa vendeve miqësore, si: Italia, Çekia, Sllovakia, Greqia dhe Kroacia, të cilat janë bërë bashkë për të çuar zërin e tyre dhe për të përshpejtuar procesin e anëtarësimit të vendeve ballkanike.

Jam shumë i lumtur që edhe samiti i Procesit të Berlinit do të zhvillohet në Tiranë, në muajin tetor. Mendoj se është një sinjal i qartë i rrugës që ka zgjedhur tashmë Shqipëria, e cila është pjesë e Europës dhe duhet të shkojë sa më shpejt drejt Europës. Është një angazhim i Europës, por, sigurisht, edhe një angazhim i Shqipërisë. Unë mendoj që, në këtë kuadër, duhet të ecim shpejt. Është e qartë që, veçanërisht në kohët e sotme të një politike shumë të pasigurt botërore nëpërmjet luftës në Ukrainë, edhe fokusi i Bashkimit European ka lëvizur dhe është spostuar drejt Ukrainës, Moldavisë dhe Gjeorgjisë. Unë, sigurisht, i kam vizituar këto vende dhe patjetër që i mbështesim këto vende, por kjo nuk do të thotë se duhet ta harrojmë Ballkanin dhe ta nxjerrim atë jashtë fokusit, përkundrazi, neve na duhet përpjekje akoma më e madhe që ta çojmë këtë proces para. Ne do të bëjmë gjithçka për t'ju mbështetur ju, edhe në procesin *screening*. Është në natyrën e parlamentarizmit që mazhoranca dhe opozita të kenë mendime të ndryshme, por edhe ju, ashtu sikurse ne, mendoni se, kur bëhet fjalë për Europën, jemi të gjithë në një qëllim të përbashkët. Kjo është baza, e cila do t'ju çojë edhe ju drejt suksesit. Për këtë jam i bindur dhe dëshiroj t'ju them se ne do ta mbështesim me plot fuqi.

Ne, në fakt, kemi folur edhe me Kryetaren gjatë bisedës bilaterale që patëm, se ne do t'ju mbështesim, sigurisht aty ku mundemi, edhe në procesin *screening*, ku do të japim ekspertizën tonë. Ne jemi të gatshëm që t'ju ndihmojmë në këtë proces, sigurisht, të sigurojmë një shkëmbim sa më të mirë, sepse edhe ne mësojmë nga kjo gjë. Kjo nuk është një rrugë pa kthim, por, në fakt, është një marrëdhënie e dyanshme, e cila na ndihmon të dyja palëve. Prandaj unë mendoj se Shqipëria edhe në këtë rrugë do të jetë shumë e suksesshme, sepse ne do të bëjmë gjithçka për ta mbështetur këtë gjë. Këtu kërkoj shumë modestisht edhe angazhimin tuaj, të parlamentarëve shqiptarë.

Edhe për sa i përket konfliktit që është ringjallur në Kosovë, neve na duhet kompromisi, na duhet të flasim me njëri-tjetrin, na duhet mundësia për ta përballuar në mënyrë diplomatike

këtë konflikt dhe jo me dhunë. Kjo është një punë që çdo parlamentar e ka të qartë, për të cilën edhe është angazhuar, por për të cilën edhe duhet të kontribuojë. Unë mendoj se edhe ju keni kontaktet tuaja parlamentare me të dyja vendet, të cilat duhet t'i motivoni dhe të mundoheni sa më shumë që ato të shkojnë drejt dialogut. Ju keni edhe një shembull nga Austria, që është Tirol i Jugut, që, në fakt, ka qenë si puna e Kosovës, ka qenë gjithmonë gjermanofolës, ka qenë gjithmonë pjesë e Austrisë dhe, prapëseprapë, sot është një vend, i cili është shumë i suksesshëm nga pikëpamja ekonomike, por që është pjesë e Republikës Italiane. Është shumë mirë që është kështu, sepse ne jemi të bashkuar në Bashkimin European; Tirol i Jugut e gjeti vendin e tij. Austria e mbështet këtë gjë dhe ne jemi sërish të bashkuar në Bashkimin European. Sigurisht që, duke u pranuar nga të dyja vendet, ka treguar një shembull të qartë se si, edhe konfliktet etnike mund të zgjidhen. Sigurisht që kjo nuk bëhet sot për nesër, plagët e hapura duhet të shërohen, por plagët që shtohen duhen shëruar edhe duke marrë medikamentet e dhura dhe jo duke i gërryer gjatë gjithë kohës. Ndoshta do të më lejoni që t'ju adresoj edhe një lutje, e të kërkoj edhe kontributin tuaj për zgjidhjen e këtij dialogu!

Unë sapo dhashë një intervistë në një kanal shqiptar dhe është shumë e rëndësishme për çdo vend që të kemi një media të pavarur. Këtë e tregon edhe raporti i vendeve për Shqipërinë, sepse, në fakt, Shqipëria ka edhe pak rrugë për të bërë në këtë fushë, por unë jam i bindur që, nëse ju e ndiqni këtë proces me aq përparësi, siç keni bërë me reformën në drejtësi dhe me luftën kundër korrupsionit, mendoj se do të ecni shumë përpara.

Unë ju uroj shumë suksese gjatë konsultimeve tuaja!

Ju uroj gjithë të mirat edhe për pushimet e ardhshme verore; ju uroj që të çlodheni sa më shumë, të gjeneroni sa më shumë fuqi dhe që të keni sa më shumë kohë edhe për familjet tuaja, sepse e di që ju merr malli dhe ju mungojnë shpeshherë, pasi edhe politikanët janë njerëz, edhe politikanët janë baballarë, janë nëna, janë bashkëshortë dhe bashkëshorte! Kështu që, ju uroj të kaloni sa më shumë kohë cilësore me familjen tuaj.

Shëndet e gjithë të mirat, dhe plot fuqi për vitin e ardhshëm!

(Duartrokite në sallë)

Lindita Nikolla – I dashur President Sobotka, faleminderit për fjalën dhe për mesazhet drejtuar Kuvendit dhe qytetarëve të Republikës së Shqipërisë!

Në emër të Kuvendit, të kolegëve dhe në emrin tim personal, ju garantoj se Kuvendi i Shqipërisë do ta vijojë partneritetin me Këshillin Kombëtar të Austrisë dhe do të nxitë marrëdhëniet e bashkëpunimit dypalësh mes vendeve, në të mirë të njerëzve tanë, në të mirë të zhvillimit, të mirëqenies, të paqes dhe sigurisë.

**Sekretare e Sekretariatit për
Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka**

**Drejtoreshë e Shërbimit të Redaktorëve
Suela Bala**

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju lutem, më lejoni të shoqëroj Presidentin Sobotka!

(Duartrokitje në sallë)

(Seanca u mbyll në orën 14:30)

Kryetarja e Kuvendit

Lindita Nikolla